



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS SUDSKI SAVET KOSOVA – KOSOVO JUDICIAL COUNCIL			
29.07.2021			
Org. Juri Org. Unit	Klas. Kod Class. Code	Id. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Lir. Prot. Lir. Prot. No. No. Pages
05	47	1405	23

Për : Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: Albert Zogaj, Kryesues i KGJK



PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

Të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në Këshillin Gjyqësor
të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës

Nr.	Gjetja/titulli	Rekomandimi	Njësia përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit/Zyrtari/ët.përgjegjës	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Koha/Data e planifikuar e zbatimit-të rekomandimit	Statusi i rekomandimit(i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar) Komente
1	SMIL-i ende nuk ka zbatim të plotë në të gjitha instancat e gjykatave dhe prokurorive. Deri më tani, SMIL-i ka arritur të zbatohet në Gjykatat dhe Prokuroritë Themelore dhe Prokurorinë e Apelit. Në Gjykatën e Apelit, Gjykatën Supreme, zbatimi i SMIL-it ka filluar në janar të vitit 2021, ndërsa në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ende nuk ka filluar përdorimi i SMIL-	1. Zbatimi dhe zhvillimi i sistemit SMIL. KGJK-ja dhe KPK-ja të zbatojnë Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor/prokurorial në Kosovë dhe të zbatojnë të gjitha proceset në sistem për trajtimin e lëndës. T'i japin prioritet zhvillimit të sistemit për finalizimin e ndërlikjes së SMIL-it të Gjykatës dhe Prokurorisë dhe zhvillimin e raporteve të avancuara statistikore në përputhje me treguesit CEPEJ për gjykatat, si dhe raportet bazike dhe të avancuara për prokuroritë;	Projekti i SMIL	Trajnimi dhe vënia në zbatim e SMIL është përfunduar në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Pa përfunduar ende ka mbetur vënia në zbatim e SMIL. vetëm edhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme është gjykata e fundit në të cilën sistemi ende nuk është vënë në zbatim, me kryerjen edhe të kësaj gjykate përfundon në tërësi vënia në zbatim e SMIL në të gjitha instancat. Projekti është duke bërë përpjekje maksimale që të përfundojë zhvillimi i SMIL edhe për DHPGJS dhe të filloj trajnimi.	31 Dhjetor 2021	I zbatuar pjesërisht. Projekti i SMIL është projekt që është në implementim e sipër dhe si projekt ende nuk ka përfunduar. Projekti është në Fazën Konsoliduese në të cilën është për objektivi vënia në zbatim e SMIL në të gjitha instancat. Tashmë, kur po bëhet ky plan pune, SMIL është vënë në zbatim në GJA dhe GJS. Ka mbetur vetëm pa vënë në zbatim sistemi në DHPGJS. I gjithë plani i punës dhe afatet kohore janë brenda objektivave të kësaj faze të projektit. Vonesa për realizimin e këtij aktiviteti në tërësi është vonesa në zhvillimin e SMIL për DHPGJS. Vonesat në

	it. Kjo për shkak që ende nuk ka përfunduar zhvillimi i SMIL-it për këto instanca.			Trajnimet dhe vënia në zbatim e SMIL në DHPGJ do të realizohet deri në fund të 2021.		zhvillim janë paraqitur për shkak të problemeve të shkaktuara nga Pandemia COVID 19.
2	Ndërlidhja e SMIL-it të gjykatave dhe SMIL-it të prokurorive për shkëmbimin e të dhënave dhe lëndëve nuk është realizuar plotësisht. Realizimi i këtij aktiviteti ka qenë i planifikuar të përfundojë në tetor të vitit 2020. Megjithatë, në gusht të vitit 2020 kishte filluar zbatim i fazës së parë të ndërlidhjes të këtyre dy sistemeve për shkëmbimin e një numri të kufizuar të shkresave. Ndërsa, faza e dytë e ndërlidhjes ende nuk është	1. Zbatimi dhe zhvillimi i sistemit SMIL. KGJK-ja dhe KPK-ja të zbatojnë Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor/prokurorial në Kosovë dhe të zbatojnë të gjitha proceset në sistem për trajtimin e lëndës. T'i japin prioritet zhvillimit të sistemit për finalizimin e ndërlidhjes së SMIL-it të Gjykatës dhe Prokurorisë dhe zhvillimin e raporteve të avancuara statistikore në përputhje me treguesit CEPEJ për gjykatat, si dhe raportet bazike dhe të avancuara për prokuroritë;	Projekti i SMIL.	Ndërlidhja e SMIL gjykatë-prokurori është ndarë në tre pjesë për tu zhvilluar dhe implementuar. Deri në momentin e përgatitjes së këtij plani ka përfunduar pjesa e parë dhe dytë dhe është vënë në zbatim. Në zhvillim është pjesa e tretë dhe e fundit. Zhvillim është planifikuar të përfundojë deri 30 Qershor 2021 dhe pastaj të vihet në zbatim.	31 Gusht 2021	I zbatuar pjesërisht. Sfida për mos realizimin e këtij aktiviteti në tërësi është vonesa në zhvillimin e ndërlidhjes së SMIL gjykatë-prokurori. Vonesat në zhvillim janë paraqitur për shkak të problemeve të shkaktuara nga Pandemia COVID 19.

	zhvilluar nga operatori ekonomik.					
3	<p>Në SMIL ende nuk janë krijuar të gjitha raportet për prezantimin e performancës dhe efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë.</p> <p>Për KGJK-në, në SMIL janë zbatuar vetëm katër raporte të cilët përmbajnë indikatorët bazik të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ). Por ende nuk janë zhvilluar nga OE raportet me indikatorë të avancuar dhe "dashboard"¹⁹, të cilat janë dizajnuar në bashkëpunim me grupin e ekspertëve²⁰ të cilët ishin angazhuar për asistencë teknike.</p>	<p>1. Zbatimi dhe zhvillimi i sistemit SMIL. KGJK-ja dhe KPK-ja të zbatojnë Sistemin Informativ për Menaxhimin e Lëndëve në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor/prokurorial në Kosovë dhe të zbatojnë të gjitha proceset në sistem për trajtimin e lëndës. T'i japin prioritet zhvillimit të sistemit për finalizimin e ndërlidhjes së SMIL-it të Gjykatës dhe Prokurorisë dhe zhvillimin e raporteve të avancuara statistikore në përputhje me treguesit CEPEJ për gjykatat, si dhe raportet bazike dhe të avancuara për prokuroritë;</p>	Projekti SMIL	<p>Deri tani janë zhvilluar dhe janë në përdorim raportet statistikore që përmbajnë të dhëna dhe indikator të CEPEJ-it me të dhëna më të përgjithshme.</p> <p>Janë dizajnuar dhe dërguar në zhvillim raportet statistikore që përmbajnë të dhëna të detajuara dhe indikator me të dhëna më të detajuara për punën e gjyqtarëve dhe gjykatave, është dizajnuar moduli i statistikave të avancuara dhe dashboard dhe janë dërguar në zhvillim. Deri tani është realizuar 80% e punës në zhvillim.</p>	31 Gusht 2021	I zbatuar pjesërisht. Sfida në kompletimin e raporteve statistikore janë vonesat në zhvillimin e tyre në SMIL.

4	<p>KGJK-ja që nga viti 2018 nuk ka hartuar plan strategjik të TI-së, për arritjen e objektivave të saj. Projekti TIK/SMIL kishte filluar të zhvillohej në pajtueshmëri me strategjinë e TIK-ut 2012-2017. Në mungesë të strategjisë, Njësia e TIK-ut për hartimin e planit vjetor të punës për arritjen e objektivave të saj, mbështetet në aktivitetet e projekteve që ka në zbatim.</p>	<p>2. Plani strategjik i TI-së. KGJK-ja të hartojë planin strategjik të TIK-ut dhe planin e veprimt për zbatimin e tij. KGJK-ja dhe KPK-ja të krijojnë mekanizma monitorues dhe raportues për zbatimin e strategjisë së TI-së si dhe të ndërmarrin veprime korrigjuese për arritjen e objektivave të strategjisë;</p>	<p>KGJK/ Zyra e TI</p>	<p>Aktivitetet kryesore për përgatitjen e planit strategjikë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krijimi i grupit punues, me përbërje nga stafi i gjykatës, KGJK si dhe përfshirja e ekspertëve të jashtëm dhe ekspertëve lokal në grup punues. - Koordinimi me projektin EUKOJust, pasi ky projekt do të ofrojë asistencë teknike për këtë aktivitet. - Draftimi i planit strategjikë. - Periudha e mbledhjes së komenteve dhe sugjerimeve. - Aprovimi i planit strategjikë në KGJK. 	<p>30 Qershor 2022</p>	<p>I pa realizuar</p> <p>Në vitit 2018, KGJK-ja ka iniciuar projektin për hartimin e dokumentit strategjik të TI-së, mirëpo në koordinim me Zyrën e EU-së është vendosur që ky projekt të financohet nga projektet e IPA-s 22. Projekti për përgatitjen e planin strategjikë për TIK për gjykata, pritet të realizohet përmes Projektit të EUKOJust-it dhe përfundojë gjatë gjysmës se pare të vitit 2022.</p>
5	<p>KGJK-ja nuk ka arritur të plotësojë objektivat e projektit TIK/SMIL të planit për ngritjen e kapaciteteve të TIK-ut, ashtu siç është miratuar nga bordit drejtues i projektit</p>	<p>3. Struktura organizative. KGJK-ja të zbatojë planin për ngritjen e kapaciteteve për ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve të TIK-ut për të siguruar kapacitetet njerëzore dhe profesionale, për ofrimin e shërbimeve</p>	<p>KGJK</p>	<p>Aktivitetet që duhet të realizohen për përmbushjen e këtij rekomandimi janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aprovimi i rregullores për organizimin e Sekretariatit të KGJK-së. Ky aktivitet pritet të realizohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021. 	<p>31 Dhjetor 2021</p>	<p>I pa zbatuar.</p> <p>Vonesa në mos zbatimin e planit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të TI-së lidhet me vonesën në mos aprovimin nga ana e KGJK-së e rregullores për organizimin e Sekretariatit të KGJK-së.</p>

	TIK/SMIL, në tetor të vitit 2016. Objektivë ishte ngritja e Zyrës për TI-në në nivel të Departamentit dhe të organizohej në dy njësi kryesore: njësinë për administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe njësinë për administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e aplikacioneve.	efikase për SMIL dhe përdoruesit e gjyqësorit, si dhe të bëj ndarjen e roleve dhe përgjegjësi të stafit të TI-së.		2. Promovimi i Zyrës së TI në Departament, të realizohet gjatë tremujorit të tretë të 2021 dhe 3. Rritja e numrit të stafit të TI-së në Departament sipas planit të aprovuar gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021.		Aprovimi i rregullores për organizimin e Sekretariatit i hapë rrugë ngritjes së zyrës së TI në Departament dhe rritjen e kapaciteteve me staf.
6	Në KGJK, për menaxhimin e brendshëm të TI-së, Njësia e TIK-ut sipas zyrtarëve të TI-së, shfrytëzojnë rregulloret dhe udhëzimet e ASI II-së dhe draft politikën dhe procedurën e departamentit të TI-së. Kjo njësi, në nëntor të vitit 2017 kishte hartuar draft rregulloren, politikën dhe	4. Politikat dhe procedurat e TI-së. KGJK-ja të rishikojë, plotësojë dhe miratojë politikat dhe procedurat e TI-së, t'i komunikojë ato me qëllim që të sigurojë udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e operacioneve të përditshme për administrimin e sistemeve të informacionit. KGJK-ja dhe KPKP-ja të krijojnë mekanizma për	KGJK	Aktivitetet që duhet të realizohen për zbatimin e këtij rekomandimi, janë të lidhura me aprovimin nga ana e KGJK-së e rregullores për organizimin e Sekretariatit të KGJK-së. Aktivitetet që duhet të realizohen janë: 1. Aprovimi i politikave dhe procedurave të TIK-ut. 2. Krijojë mekanizma për zbatimin e politikave dhe procedurave të TIK-ut.	31 Mars 2022	I zbatuar pjesërisht. Vonesa në mos aprovimin e politikave dhe procedurave të përgatitura të TIK-ut në KGJK ka qenë për shkak të mos aprovimin nga ana e KGJK-së e rregullores për organizimin e Sekretariatit të KGJK-së. Aprovimi i rregullores për organizimin e Sekretariatit i hapë rrugë aprovimit të rregulloreve, politikave

<p>procedurën e departamentit të TI-së, për të filluar me zbatimin e tyre. Në dhjetor 2017, i kishte dërguar ato për miratim te menaxhmenti i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK). Nga këto dokumente, Këshilli kishte miratuar vetëm rregulloren për shfrytëzimin e teknologjisë informative të komunikimit në sistemin gjyqësor, ndërsa politika dhe procedura e departamentit të TI-së nuk ishte miratuar për arsye se SKGJK-ja ishte në fazën e ndryshimit të rregullores së organizimit të brendshëm të saj dhe pas miratimit</p>	<p>monitorimin e zbatimit të politikave si dhe hartojë raporte për nivelin e zbatimit të tyre.</p>		<p>3. Krijojë raporte periodike për zbatimin e politikave dhe procedurave. 4. Përditëson në afate kohore periodike të rregullta politikat dhe procedurat.</p> <p>Afatet për realizimin e këtij aktiviteti duhet koordinuar me projektin PAJI të financuar nga MCC. Një nga objektivat e projektit PAJI është ngritja e kapaciteteve të sigurisë në TIK. Me këtë rast, pjese e planit të punës është edhe asistencë teknike në avancimin e politikave dhe procedurave dhe pastaj aprovimin e tyre në KGJK.</p>		<p>dhe procedurave tjera në fushën e TIK-ut. Ky aktivitet kërkon koordinim me projektin e MCC/PAJI, për të përfituar asistencë teknike në fushën e sigurisë së TI-ut dhe draftimit të politikave dhe procedurave.</p>
---	--	--	---	--	---

	të saj pritej të miratoheshin këto dokumente.					
7	KGJK-ja, ka përcaktuar kriteret për shpërndarjen e lëndëve në Gjykatat e RKS-së, për t'i zbatuar ato në SMIL. Në SMIL shpërndarja e rastësishme e lëndëve në mënyrë automatike të gjyqtarët sipas departamenteve/ divizionit është e aplikuar në nivelin e Gjykatave Themelore të Kosovës. Mirëpo, krijimi i anëtarëve të panelit në mënyrë automatike, në Gjykatën Themelore ende nuk është zhvilluar edhe pse është e përcaktuar në dokumentin e Kriterëve për	5. Shpërndarja automatike e lëndëve në SMIL. KGJK-ja, të zhvillojë dhe zbatojë funksionin e krijimit të paneleve në mënyrë automatike për të gjitha gjykatat dhe të zbatojë shpërndarjen e lëndëve automatike për gjyqtarë në të gjitha instancat e Gjykatave.	KGJK Projekti SMIL	Janë definuar të gjitha specifikacionet për zhvillimin e SMIL për krijimin e paneleve për gjykatat themelore, kërkesat funksionale janë dërguar në KGJK për aprovim. Me aprovimin e tyre në KGJK do të fillohet me zhvillim dhe vënie në zbatim. Për Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, shpërndarja automatike është në zhvillim. Zhvillimi pritet të përfundojë dhe vihet në zbatim gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021.	31 Dhjetor 2021	I zbatuar pjesërisht. Sfida në kompletimin e zhvillimit të shpërndarjes automatike të lëndëve janë vonesat në zhvillimin e tyre në SMIL.

<p>Shpërndarje të Lëndëve. Propozimi për krijimin automatik të anëtarëve të paneleve nga projekti TIK/SMIL është përgatitur, mirëpo KGJK-ja ende nuk ka miratuar propozimin që të zhvillohet dhe zbatohet në SMIL. Ndërsa, shpërndarja e lëndëve automatike nuk zbatohet në Gjykatën e Apelit për shkak që ende janë në fazën fillestare të zbatimit të SMIL-in dhe në Gjykatën Supreme për shkak që ende nuk ka përfunduar trajnimi për përdorimin e SMIL-it.</p>					
--	--	--	--	--	--

8	<p>KGJK-ja deri më tani nuk ka arritur të bëjë një vlerësim të përdorimit të SMIL-it për t'u siguruar nëse të gjitha veprimet të cilat janë ndërmarrë për një lëndë janë të regjistruara në këtë sistem, përkatësisht e gjithë dosja elektronike e lëndës në sistem është identike me dokumentet e dosjes fizike.</p>	<p>6. Përdorimi i SMIL-it. KGJK-ja të bëjë vlerësimin për përdoruesit e SMIL-it në gjykatat e Republikës së Kosovës, që të sigurohet që çdo veprim i bërë nga regjistrimi i lëndës deri në zgjidhje të saj është zbatuar në sistem me kohë;</p>	KGJK	<p>KGJK do të krijoj një grup punues, me përbërje me anëtar nga KGJK, komisioni i inspektimit gjyqësore dhe Sekretariati për të bërë një analize të nivelit të përdorimit të SMIL nga stafi i gjykatave. Të identifikohen veprimet që duhet të merren nga KGJK për të siguruar përdorimin e plotë të sistemit.</p> <p>Ne bazë të raportit, KGJK do të marrë veprimet e duhura. Grupi punues do të krijohet gjatë tremujorit të fundit të vitit 2021 dhe raportin planifikohet ta dorëzoj në fund të tremujorit të parë të vitit 2022.</p>	31 Mars 2022	<p>I pa realizuar.</p> <p>Situata e pandemisë ka bërë të pamundur realizimin e këtij aktiviteti gjatë vitit 2020 dhe 2021.</p>
9	<p>KGJK-ja nuk ka politikë për sigurinë e informacionit dhe zyrtar për sigurinë e informacionit.</p>	<p>7. Struktura e sigurisë së TI-së. KGJK-ja dhe KPK-ja të sigurojnë zyrtarë për sigurinë e informacionit në secilën nga këto dy institucione që të</p>	KGJK	<p>Aktivitetet që duhet të realizohen për përmbushjen e këtij rekomandimi janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aprovimi i rregullores për organizimin e Sekretariatit të KGJK-së. 	31 Dhjetor 2021	<p>I pa realizuar.</p> <p>Sfidat për mos realizimin e këtij aktiviteti kanë qenë të lidhura me vonesat në ngritjen e kapaciteve të zyrës së TI në KGJK.</p>

	<p>Në planin për ngritjen e kapaciteteve për ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve të TIK-ut, është përcaktuar pozita "Specialist i Sigurisë". Për shkak që KGJK-ja nuk ka arritur ta miratojë rregulloren e re mbi organizimin e SKGJK-së, kjo pozitë nuk është plotësuar, përderisa realizon aktivitetet e saj pa politikën për sigurinë e informacionit.</p>	<p>mundësojnë operim të sigurt të pajisjeve përpunuese;</p>		<p>Ky aktivitet pritet të realizohet gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021.</p> <p>2.Promovimi i Zyrës së TI në Departament, të realizohet gjatë tremujorit të tretë të 2021 dhe</p> <p>3. Rekrutimi i një Zyrtari të TI për siguri. Afati për realizimin e këtij aktiviteti është tremujori i katërt i vitit 2021.</p>		
10	<p>KGJK-ja nuk ka politikë për sigurinë e informacionit dhe zyrtar për sigurinë e informacionit. Në planin për</p>	<p>7.1. Politika e sigurisë së informacionit. KGJK-ja të hartojë, miratojë dhe të zbatojë politikën për sigurinë e informacionit, që të mundësojë operim të</p>	KGJK	<p>Aktivitetet që duhet të realizohen për zbatimin e këtij rekomandimi, janë të lidhura me aprovimin nga ana e KGJK-së e rregullores për</p>	31 Mars 2022	<p>I zbatuar pjesërisht.</p> <p>Zyra e TI ka përgatitur qysh në 2017 draftet për politikën dhe procedurat e sigurisë së TIK-ut. Mirëpo aprovimi i tyre</p>

	<p>ngritjen e kapaciteteve për ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve të TIK-ut, është përcaktuar pozita "Specialist i Sigurisë". Për shkak që KGJK-ja nuk ka arritur ta miratojë rregulloren e re mbi organizimin e SKGJK-së, kjo pozitë nuk është plotësuar, përderisa realizon aktivitetet e saj pa politikën për sigurinë e informacionit.</p>	<p>sigurtë të pajisjeve përpunuese;</p>		<p>organizimin e Sekretariatit të KGJK-së. Aktivitetet që duhet të realizohen janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aprovimi i politikave dhe procedurave të TIK-ut. 2. Krijohë mekanizma për zbatimin e politikave dhe procedurave të TIK-ut. 3. Krijohë raporte periodike për zbatimin e politikave dhe procedurave. 4. Përditëson në afate kohore periodike të rregullta politikat dhe procedurat. <p>Para aprovimit të politikave, dokumentet do të përditësohen nga ekspertet e Projektit MCC/PAJI.</p>	<p>është shtyrë deri në aprovimin e rregullores për organizimin e brendshëm të Sekretariatit të KGJK. Gjatë kësaj periudhe janë zbatuar rregullorja për përdorimin e TIK në gjyqësor dhe rregullorja për përdorimin e SMH, të aprovuara në KGJK, si dhe janë zbatuar politikat dhe procedurat e ASHI të cilat janë të vlefshme për të gjitha institucionet shtetërore. Politikat dhe procedurat e ASHI do të zbatohen derisa KGJK të aprovon politikat dhe procedurat e saja.</p> <p>Drafti i rregullores për Sekretariatit është gati për aprovim në KGJK. Në ndërkohë, Zyra e TI është duke punuar për të përditësuar draftet e përgatitura më herët. Për këtë qëllim do të angazhohen eksperte nga projekti i PAJI të financuar nga MCC. Një nga objektivat e projektit PAJI është</p>
--	---	---	--	--	---

						ngritja e kapaciteteve të sigurisë në TIK. Me këtë rast, pjesë e planit të punës është edhe asistenca teknike në avancimin e politikave dhe procedurave dhe pastaj aprovimin e tyre në KGJK.
11	KGJK-ja nuk ka realizuar trajnime të stafit për vetëdijesimin e përdorimit të sistemeve dhe sigurisë së informacionit. Sipas zyrtarit përgjegjës, prioritet i është vënë që t'i nxisin përdoruesit të përdorin SMIL-in.	8. Plani i trajnimeve. KGJK-ja të hartojë dhe zbatojë një program të trajnimeve për vetëdijesimin e të gjithë stafit mbi sigurinë e informacionit;	Projekti SMIL Zyra e TI	Aktivitetet dhe afatet për realizimin e trajnimeve: 1. Identifikimi i nevojave për trajnime dhe përgatitja e resurseve për ofrimin e trajnimit. Përgatitja e materialeve të trajnimit. Tremujori i parë 2022. 2. Ofrimi i trajnimit. Tremujori i dytë 2022.	30 Qershor 2022	I pa realizuar. Sfidat për mos realizimin e këtij aktiviteti kanë qene te ndërlidhura me Pandeminë COVID 19 dhe me trajnimet për vënien në zbatim të SMIL, me ç' rast i është dhënë prioritet trajnimeve për përdorimin e SMIL.

12	<p>Në Qendrën e të Dhënave të përbashkët për KGJK-në dhe KPK-në ishin të autorizuar për qasje më shumë se nga një person (zyrtarë të TI-së) për të dy institucionet. Kjo kishte ndodhur në mungesë të procedurës së veçantë për qasje në qendrën e të dhënave dhe duke iu mundësuar qasje këtyre zyrtarëve pa pasur rolin për administrimin e qendrës së të dhënave. Gjithashtu, zyrtarit të TI-së i është mundësuar qasje në Qendrën e të Dhënave nëpërmjet dy llogarive/kartelave për qasje, të regjistruara në</p>	<p>9. Qasje fizike për sigurimin e pajisjeve të TI-së. KGJK-ja dhe KPK-ja të hartojnë, miratojnë dhe të zbatojnë procedurën për qasje në Qendrën e të Dhënave</p>	<p>Zyra e TI</p>	<p>KGJK dhe KPK duhet të përgatisin procedurat e përbashkëta për qasjen fizike në qendrën e të dhënave. Aktivitetet kryesore: 1. Përgatitja e draftit të procedurave tremujori i parë 2022 dhe 2. Aprovimi i tyre në KGJK dhe KPK, tremujori i dytë 2022.</p>	<p>30 Qershor 2022</p>	<p>I zbatuar pjesërisht</p> <p>Aktualisht procedurat për siguri të qendrës së të dhënave janë të përfshira në kuadër të dokumenteve tjera të aprovuara në zbatim, mirëpo plani është të avancohen në procedura të veçanta vetëm për qendrën e të dhënave.</p>
----	---	---	------------------	--	------------------------	---

	emrin e tij. Ky zyrtar ishte i autorizuar edhe për hapjen llogarive/karteleve për qasje në këtë qendër					
13	KGJK-ja dhe KPK-ja nuk përdorin plotësisht sistemet për menaxhimin e incidenteve për regjistrimin e incidenteve/gabi meve që ndodhin në infrastrukturën e TI-së, duke qenë se këto sisteme janë vënë në përdorim në të njëjtën kohë me sistemin SMIL, i cili ka pasur prioritet të zbatimit. KGJK-ja ka dy sisteme për menaxhimin e incidenteve JIRA	10. Menaxhimi i incidenteve dhe problemeve. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të marrin vendim që obligon të gjithë përdoruesit e sistemeve të informacionit të përdorin sistemet për menaxhimin e incidenteve dhe asnjë kërkesë të mos trajtohet në asnjë hap jashtë këtyre sistemeve;	KGJK Zyra e TI	Për realizimin e këtij aktiviteti duhet: 1. Stafi i TI në KGJK dhe KPK të përgatisin draftin e Marrëveshjes për nivelin e ofrimit të shërbimeve (Ang. Service Level Agreement SLA). Tremujori i katërt 2021. 2. Grupi Punues i Përdoruesve të SMIL të aprovoj Marrëveshjen për Nivelin e Ofrimit të Shërbimeve. Tremujori i katërt 2021. 3. Të bëhet trajnimi i përdoruesve për përdorimin e sistemit për menaxhimin e incidenteve.	30 Qershor 2022	I zbatuar pjesërisht Pandemia COVID 19 ka bërë të pamundur realizimin e këtij aktiviteti në tërësi. Për shkak të pandemisë, Grupi Punues i Përdoruesve të SMIL kishte kërkuar që prioritet të jepet trajnimeve për përdorimin e SMIL, ndërsa trajnimet për përdorimin e sistemit për menaxhimin e incidenteve, trajnimet të realizohen pasi trajnimet për SMIL të përfundojnë në tërësi

	<p>dhe SYS AID, ndërsa KPK ka sistemin JIRA dhe InvGate. Këto sisteme, për momentin, përdoren vetëm nga zyrtarët e TIsë dhe departamenti i TIsë, por nuk përdoren plotësisht nga përdoruesit e fundit (gjyqtarë/prokurore dhe zyrtarët administrativ), të cilët problemet i lajmërojnë në forma të tjera si telefon, Email, etj.</p>					dhe situata e pandemisë të tejkalohet.
14	<p>Në KGJK dhe KPK ende nuk kanë përfunduar të gjitha fazat e zhvillimit në SMIL, andaj për realizimin e zhvillimeve dhe ndryshimeve në këtë sistem, zhvilluesit e</p>	<p>11. Politika e kontrollit të qasjes. KGJK-ja dhe KPK-ja të kufizojnë numrin e përdoruesve me qasje të plotë të lejuara në serverin e aplikacionit dhe bazës së të dhënave për SMIL-in, për kontraktuesit e</p>	Zyra e TI	<p>KGJK e ka krijuar një procedurë për lidhur me deploy të versioneve të reja në serverin në prodhim, kjo procedurë përfshin krijimin e një serveri të veçantë për deploy të versioneve ku janë të instaluar të gjitha veglat e nevojshme për marrjen e versionit të ri nga serveri i</p>	Në zbatim.	<p>Në mungesë të kapaciteteve të brendshme për të zhvilluar dhe mirëmbajtur SMIL, KGJK dhe KPK janë të obliguara të kontraktojnë këto shërbime. Qasja në sistem për nevoja të zhvillimit dhe mirëmbajtjes është e</p>

<p>kontraktuar nga konzorciumi kanë qasje në serverin real (të prodhimit) të aplikacionit dhe bazës së të dhënave të SMIL-it. Kjo është bërë për shkak të mungesës së kapaciteteve të brendshme të stafit të IT-së në KGJK dhe KPK. Gjithashtu, për ndryshimet në bazën e të dhënave në KGJK përdorej llogaria gjenerale "sa38" e bazës së të dhënave, për shkak të mos përfundimit të zhvillimit duke qenë se disa nga ndryshimet nuk kanë mundur t'i</p>	<p>jashtëm t'u lejohet qasja kur është e nevojshme, të monitorohet dhe pas përfundimit të aktiviteteve/punës qasja t'u mbyllet. Të pasivizojë llogarinë e përgjithshme të bazës së të dhënave "sa" dhe të përdorë llogaritë që identifikojnë përdoruesin dhe çdo ndryshim që ai bën;</p>		<p>kompanisë dhe publikimi i këtij versioni në serverin në prodhim. Qasja në serverin në prodhim është e kufizuar si nga aspekti i përdoruesit po ashtu edhe nga aspekti i IP (vetëm IP e këtij serveri ka qasje) si dhe në nivel të portave. Vlen të theksohet se në këtë server kanë qasje vetë personat nga ZTI. Gjithashtu sa i përket llogarisë "sa" është pasivizuar me kohë. Sa i përket , qasjes për kontraktuesit e jashtëm u lejohet qasja vetëm në rastet shumë të veçanta kur kemi probleme me ndonjë bug edhe atë vetëm nën monitorimin nga ana e zyrtarëve të ZTI dhe pas përfundimit të aktiviteteve/punës qasja për këta përdorues pasivizohet.</p>		<p>rregulluar me politikat dhe procedurat më të mira në fushën IT Service Mangement.</p>
--	--	--	---	--	--

	realizojnë ndryshe.					
15	<p>KGJK-ja dhe KPK-ja nuk kanë ndërprerë qasjen në SMIL për një numër përdoruesish të cilëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Po ashtu, nuk iu kanë ndryshuar rolet në SMIL përdoruesve të cilët kanë ndryshuar marrëdhënien e punës. Sipas zyrtarëve të KGJK-së dhe KPK-së, kjo kishte ndodhur se disa përdorues (gjyqtarë/prokurorë) për të cilët figurojnë llogaritë aktive janë të ngarkuara me detyra (lëndë) të pazgjidhura dhe është kërkuar ricaktimi i atyre detyrave (lëndëve)</p>	<p>11.1 Qasja logjike. KGJK-ja dhe KPK-ja të pasivizojnë llogarinë e përdoruesit menjëherë pas njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe të bëjnë ndryshimin e rolit për ata që kanë ndryshuar pozitën e punës. Të realizojnë bartjen e lëndëve në SMIL nëpërmjet llogarisë aktive të Kryetarit të Gjykatës/ Kryeprokurorit nga gjyqtari/prokurori që ka ndërprerë marrëdhënien e punës të gjyqtarët/prokurorët e tjerë, pa qenë e nevojshme mbajtja aktive e llogarisë, apo ri-aktivizimi i saj;</p>	<p>Zyra e TI Zyra e personelit</p>	<p>KGJK ka adresuar këtë të gjetur, Zyra e Personelit për çdo avancim, rekrutim të ri, ndryshim i vendit të punës, pensionim apo largime nga detyre e njofton Zyrën e TI për këto ndryshime. Zyra e TI në përputhje me ndryshimet, merr veprimet për llogaritë e përdoruesve.</p>	<p>I zbatuar.</p>	<p>Sfida kryesore për vështirësitë e realizimit të këtij aktiviteti ka qenë periudha kur gjykatat kanë pasur kompetenca për rekrutimin, transferimin apo edhe promovimin e stafit në detyre. Gjate kësaj periudhe, gjykatat nuk kanë raportuar me kohë për ndryshimet në staf dhe për këtë ka pasur sfida konkrete. Gjithashtu, vështirësi kanë qenë edhe rastet kur gjyqtarët janë promovuar në detyre apo kanë ndërruar departamentin, ndërsa në departamentin ku kanë punuar nuk i kanë kryer të gjitha detyrat me lëndë. Në këto raste ka qenë problem mbyllja e llogarisë për shkak të detyrave të pa mbyllura.</p>

	<p>të përdoruesit (gjyqtarët/prokurorët) e tjerë. Ndërsa, përdoruesit që nuk i kanë rolet e njëjta me ato në akt emërimi, arsyeja qëndron se këta përdorues janë të ngarkuar me detyra shtesë.</p>					
16	<p>Nuk kanë procedurë për rishikimin e të drejtave të qasjes së përdoruesve në baza kohore të caktuara, prandaj, kemi hasur edhe në llogari aktive të përdoruesve që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës.</p>	<p>12. Menaxhimi i privilegjeve të përdoruesve për sigurimin e informacionit. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të krijojnë procedurën për rishikimin e privilegjeve të përdoruesve në baza kohore. Të pasivizojnë llogaritë e personave që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës. Të sigurojnë mekanizmat për monitorimin e gjurmueshmërisë të aktiviteteve të përdoruesve në sistemet e informacionit.</p>	Zyra e T1	<p>Profilet e përdoruesve të SMIL janë profile të pandryshueshme, të drejtat e profileve në sistem nuk ndryshohen. Këto të drejta janë të përcaktuara në rregullore për përdorimin e SMIL dhe aprovuar në KGJK. Kjo e gjetur është adresuar si duhet në pikën paraprake, të paraqitur në rekomandimin 11.1.</p>	I zbatuar	

17	Në SMIL nuk ka të vendosur kompleksitet për fjalëkalimet e përdoruesve dhe nuk ka të vendosur kufizim të mbylljes së aplikacionit për kohën jo aktive. KGJK-ja dhe KPK-ja kanë vendosur kompleksitetin e fjalëkalimeve në Active Directory vetëm për stafin e TI-së dhe kufizimin e kohës jo aktive të kompjuterit për të gjithë përdoruesit.	12.1. Parametrat e sigurisë së qasjes. KGJK-ja dhe KPK-ja duhet të vendosin kompleksitetin për fjalëkalimet e përdoruesve dhe kufizimin kohor për mbylljen e aplikacionit për kohën jo aktive në SMIL.		Gjatë vitit 2022, do të bëhet një vlerësim i situatës për të kthyer në zbatim pasvordin kompleks për të punësuarit. Përdorimi i pasvordit kompleks do të përfshihet në trajnime që do të organizohen në fushën e TIK-ut dhe sipas nevojë do të organizohen edhe trajnime të veçanta.	I zbatuar pjesërisht	Sfidat për mos realizimin e këtij aktiviteti në tërësi kanë qenë për shkak të njohurive të kufizuara të të punësuarve në përdorimin e teknologjisë. Ky aktivitet ishte vënë në zbatim, mirëpo për shkak të problemeve që kishin të punësuarit me pasvordin kompleks, ishim të detyruar ta ndalim pasvordin kompleks për të punësuarit.
18	KGJK-ja dhe KPK-ja nuk kanë qendër të rimëkëmbjes dhe plan të vazhdimësisë së punës së	13. Plani dhe politikat për vazhdimësinë e biznesit. KGJK-ja dhe KPK-ja të hartojnë, miratojnë dhe të zbatojnë planin e rimëkëmbjes në rast të		Për shkak të mungesës së buxhetit, zbatimi i këtij projekti do të realizohet përmes asistencës financiare të projektit të EUKOJust.	I pa realizuar.	Mungesa e buxhetit ka qenë arsyeja për mos realizimin e këtij aktiviteti deri tani. KGJK dhe KPK kanë adresuar mungesën e buxhetit të donatoreve

<p>sistemeve të informacionit, për rimëkëmbjen në rast të fatkeqësive për qendrën e të dhënave primare (DRP), i cili do t'i mundësonte vazhdimësinë e shërbimeve kritike dhe proceseve të punës në rast të një ndërprerje. Mirëpo, kanë realizuar kopje rezervë të sistemeve dhe bazës së të dhënave, së bashku me infrastrukturën kritike duke krijuar redundancë të serverëve dhe infrastrukturës së rrjetit. KPK-ja një herë në muaj sipas planit/procedurave të saj bën testimin e kopjeve rezervë për rikthimin e tyre dhe krijon raporte</p>	<p>fatkeqësive për qendrën e të dhënave i cili do t'i mundësonte vazhdimësinë e shërbimeve kritike në rast të një ndërprerje të aktiviteteve.</p>		<p>Për ndërtimin e qendrës së rimëkëmbjes, projekti EUKOJust, gjatë vitit 2021 do të bëjë vlerësimin e nevojave dhe planifikimin për ndërtimin e qendrës. Kurse gjatë vitit 2022 të kryhen punimet për ndërtimin e qendrës.</p>		<p>dhe me këtë rast është arritur që projekti për qendrën e rimëkëmbjes të financohet përmes projektit EUKOJust si pjesë e projekteve të IPA.</p>
--	---	--	---	--	---

<p>të testimit, ndërsa KGJK-ja nuk ka bërë teste për kopjet rezervë. Po ashtu, KPK-ja duke marrë parasysh rëndësinë e sistemit të informacionit për menaxhimin e lëndëve për prokurorët dhe stafin mbështetës, ka paraparë në planin strategjik të TIK-ut nevojën për krijimin e planit të rimëkëmbjes dhe gjithashtu, ka filluar ndërtimin e një qendre të rimëkëmbjes. Kjo qendër planifikohet që të realizohet nga programi për financim Korporata Sfidat e Mileniumit (MCC) që të blihet "storage". Ndërsa në KGJK, për shkak të</p>					
--	--	--	--	--	--

<p>financimeve të vazhdueshme që bëhen në sistemet primare, qendrën për rimëkëmbje planifikojnë ta shfrytëzojnë të gatshme nga një institucion tjetër shtetëror</p>					
---	--	--	--	--	--

